



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË
EITI ALBANIA**

SEKRETARIATI I NISMËS PËR TRANSPARENÇË NË INDUSTRIËNXJERRËSE

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI
(SHËRBIME KONSULENCE– PËRZGJEDHJA E FIRMAVE)**

**Republika e Shqipërisë
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Sekretariati i Nismës për Transparençë në Industrinë Nxjerrëse
Granti Nr.: TF 014999**

Titulli i paketës: Studim i fizibilitetit për shtrirjen e EITI në sektorin e Hidroenergjisë/EITI Scoping study for Hydroenergy sector.

Nr. i Referencës: ALBEITI/CQ/003

Kjo Kërkesë për Shprehje Interesi publikohet pas Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, i publikuar në Development Business online No. wb1346-03/14, të datës 7 Mars 2014.

Republika e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore për llogari të Nismës për Transparençë në Industrinë Nxjerrëse (ALBEITI) dhe synon të përdorë një pjesë të financimit nga Granti për shërbimet e konsulencës për përzgjedhjen e një Firme për EITI Scoping study for Hydroenergy sector.

Shërbimet e konsulencës (“Shërbimet”) përfshijnë përzgjedhjen e një firme kompetente dhe të besueshme për të ofruar shërbimet për të kryer një studim për vlerësimin e kontributit të sektorit të prodhimit hidro-energjisë në ekonominë shqiptare dhe përfshirjen e saj nën "kuadrin" e raporteve EITI të Shqipërisë.

Periodha e zbatimit të kontratës do të jetë afërsisht 40 ditë kalendarike nga nënshkrimi i Kontratës.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë fton firma konsulente të përshtatshme (“Konsulentë”) të shprehin interesin e tyre në ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të japin informacion që paraqet kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencën e përshtatshme për të kryer Shërbimet. Kriteret e përfshirjes në listën e shkurtër janë: kualifikimet e përgjithshme të Konsulentit, disponueshmëria e kualifikimeve të duhura të stafit, përvojë në përgatitjen e studimeve dhe vlerësimin e sfondit fiskal në sektorin e hidro-energjisë/ përshkrime të kontratave të ngjashme, njohja e kuadrit ligjor, fiskal dhe atij rregullator të zbatueshëm në Shqipëri. Preferohet përvoja e dëshmuar në lidhje me EITI.

Konsulentëve të interesuar iu kërkohet t'i kushtojnë vëmendje paragrafit 1.9 të Udhëzimeve të Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve sipas Huave të IBRD dhe Kredive dhe Granteve të IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore, të datës Janar 2011* ("Udhëzimet për Konsulentët"), që përcakton politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e bashkimit të operatorëve ose të nënkosulencës për të rritur kualifikimet e tyre.

Një Konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (CQ) të përcaktuar në Udhëzimet e Konsulentëve.

Më shumë informacion mund të merret në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08.00 deri 16.30 nga e hëna deri të enjten dhe 08.30 deri 14.00 të premten.

Shprehjet e interesit mund të dorëzohen zyrtarisht në adresën e mëposhtme (personalisht, ose me postë, ose me faks, ose me e-mail) deri më 12. 01. 2015

Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (ALBEITI)

Në vëmendje të: Znj. Dorina Çinari, Drejtuese e Sekretariatit ALBEITI

Godina 3, mbrapa Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kati V,

Zyra Nr. 406, Tiranë

E-mail: Dorina.Cinari@albeiti.gov.al